



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA KAMEZ

RELACIONI TEKNIK

PER PROJEKTIN E ZBATIMIT OBJEKTI: Rikualifikimi Urban Biloku Babrru-Qender

Punoi:

Ark . Bledar Koskija

Ing. Hajredin MURGU

Drejtori i P.K.ZH.T-se

Ark. ArberTOLA

MIRATOI

Xhelal MZIU

KRYETAR

OBJEKTI: RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT BABRRU - QENDER

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TEKNIK

1. TË PËRGJITHSHME

- 1.1- Hyrje
- 1.2- Pozicioni i objektit
- 1.3- Gjendja Ekzistuese
- 1.4- Kushtet Klimatike te Zones
- 1.5- Rilevimi Topografik
- 1.6- Studimi Gjeologjik

2. ZGJIDHJA E PROJEKTIT

2.1- Projekti i Bllokut

- 3. SIPERFAQJA E PERGJITHESHME ESHTË afro $S=102\ 000\ M^2$
- 4. GJATESIA E RRUGEVE ESHTË afro $L=2000\ ML$
- 5. SIPERFAQE TROTUAR $5500\ m^2$
- 6. KANALIZIME TE UJRAVE TE BARDHA $3415\ ML$
- 7. KANALIZIME TE UJRAVE TE ZEZA $2901\ ML$
- 8. GJELBRIM LULISHTË $2600\ M^2$

3. PREVENTIVI I PUNIMEVE

- 1. Preventivi i Punimeve te Rikualifikimit te Bllokut Babrru Qender.

1. PERMBAJTJA E PROJEKT-ZBATIMIT

1) TE PERGJITHSHME

1.1-Hyrje

Bashkia Kamez me fondet e vena ne dispozicion do te realizoje projektin e zbatimit per objektin : **RIKUALIFIKIMI URBAN I BLOKUT BABRRU –QENDER**

1.2-Pozicioni gjeografik i objektit

Objekti që merret në studim gjëndet në Jug Perendim te Njesise Administrative Paskuqan Dhe JugLindje te Bashkise Kamez dhe eshte Qendra Kryesore e Babrru qender te Njesise Administrative Paskuqan

- Kamza është një qytet që shtrihet ne kufijtë veriorë të qytetit të Tiranës, që është rritur me ritme të jashtëzakonshme në dhjetëvjeçarin e fundit dhe pritet të vazhdojë rritjen demografike me ritme të konsiderueshme në 20 vitet e ardhshme.
- Zona qe trajtohet ne kete projekt perfaqeson nje teren me pjerrresi te bute ne drejtim te veriut - jugut e cila ndodhet prane lumit te Tiranës. Kjo perfaqeson nje zone urbane relativisht te dendur veçanerisht, me ndertime 1-6 kate .

1.3 -Gjendja ekzistuese

Gjendja aktuale e objektit paraqitet:

Rruga ``Demokracia Loti Pare`` eshte nje rruge qe shtrihet paralel me bregun e lumit te Tiranës

Eshte nje rruge e Shtruar por e Demtuar me trotuar te Vogla qe variojne 1.2-1.4 m

Projekti eshte studiuar, hartuar dhe perpunuar ne baze te Detyres se

Projektimit te dhene nga ish Bashkia Kamez, Tirane.

Babrru Qendra eshte lagjia e vetme e Njesise Administrative Paskuqan , e ndertuar para viteve 1990 me pallate nga 2 kate deri ne 5 kate. Gjate viteve te tranzicionit jane bere shurne nderttrne te tilla si avlli garazhe etj te cilat kane ngushtuar rruget dhe kane zene sheshet e lira. Nevoja e nderhyrjes ne sheshet dhe rruget e kesaj qendre te banuar eshte bere e domosdoshme. Infrastruktura e rrjetit inxhinierik eshte e amortizuar. Rrjeti rrugor aktual eshte me disa rruglca shume te ngushta. Detyra e Projektimit percakton qe ne projektin e Planit Rregullues Urbanistik te parashikohet zgjerimi i rrugicave dhe ndertimt i nje sistemi rrugor qe t'i sherbeje sa me mire kesaj zone te banuar. Po keshtu ne detyre percaktohet qe bashke me sistemin rrugor te behet zgjidhja e skemave funksionale edhe per elementet e tjere te rrjetit inxhinierik si kanalet e ujrave te zeza, magjistrali i tubit te ujesjellsit, ndrldm! elektrik i rrugeve dhe shesheve, linjat e furnizimit me energji elektrike dhe linjat e tetefonise.

Numri i banorve te kesaj lagjeJe per momentin sipas te dhenave te komunes eshte 10000 banore. Si qender e banuar dhe me shurne banore ku ndodhen edhe institucione si ndertesa e Kornunes, qendra shendetsore, shkolla etj behet e domosdoshme nderhyrja me investime ne infrastrukture.

PRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE.

Per hartimin e projektit 'PLANI RREGULLUES BABRRU' ne radhe te pare u inspektua gjendja ekzistuese e rrugeve dhe te gjithe elementeve te Infrastruktures qe lidhen me rrugen. Rruget jane te pa shtruara ne pjesen me te madhe te gjatesise. Gjate diteve me shi, gropat e rruges mbushen me uje dhe me gjithe zhavorrin e shtruar para shurne kohesh balta eshte prezente ne rruge, gje qe ben te veshtire kalimin ne kernbe i banoreve si dhe te mjeteve. Gjate ditteve me diell dhe me mot te thate prezenca e pluhurit eshte peret] kufijve te lejuar te ndotjes.

ZGJIDHJA URBANISTIKE

Pasi u anlizua gjendja ekzistuese, u pa dinamika e ndrtimit si dhe tendencat e formimit te kesaj qendre te banuar u hartua nje sistem rrugor i cili te krijonte nje komoditet levizjeje persa i perket automjeteve ashtu dhe banoreve. Siperfaqia rrugore duhet te ishte minimale ne rmenyre qe prishjet te ishin sa me te pakta. Gjithashtu faktor tjetër percaktues ka qene perqendrimi i Infrastruktures gjate akse



rrugore. Skema e qarkullimit automobilistik është hartuar me unaza me sens unik duke synuar gjatesi rruge minimale për çdo destinacion. Kjo ka diktuar dy gjeresi rruge tipatë 3.5m dhe 6m për ato pak segmente që kemi qene të detyruar të projektojmë me dy kalime. Lidhja me rrjetin rrugor ekzistues është bërë në pjesën veriore në disa pika duke shmangur lidhjen me unazën e madhe të Tiranës në pjesën jugore. Rruget e reja janë pothuaj mbi rruget ekzistuese. Gjeresia e trotuareve rregjithese është projektuar me gjeresi konstante 1.2m ajo mund të varlojë sipas

situatës së godinave ekzistuese duke u zgjeruar ose ngushtuar. Megjithatë

mundësitë kanë qene shurne të kufizura [anë planifikuar edhe dy sheshe me gjelberim dhe një shesh parkimi i përqendruar afër zonës së shërbimit ku gjendet ambulanca dhe kopeshti, Rruget janë planifikuar pa parkim por vetëm për qarkullim automjetesh të lehta dhe zjarrfiksi në rastet ekstreme. Të gjitha profilet rrugore [anë të paisura me rrjet infrastrukturë duke ofruar edhe pika lidhje të shpeshta për grupe godinash. Ndriçimi rrugor do të japë një pamje me të qyteteruar perspektivave rrugore duke unifikuar deri diku fasadat e cregullta dhe me akse e orientime të krejt të rastit. Sidoqoftë kjo nderhyrje mund të konsiderohet si një fazë e parë sepse nuk është ndehyre rrjetin sekondar si atë rrugor ashtu dhe të ujsjelles-kanalizime. Ky projekt duhet zbatuar si një i plotë pasi zbatimi i pjesëshërni i tij apo me modifikime dote sillte kolaps për së i perket rrjeteve të kanalizimeve si dhe qarkullimit automobilistik.

Rilevimi Topografik

Për këto rruge është bërë marrja e leximeve topografike duke përdorur sistemin GPS. Kështu të gjitha koordinatat janë në sistemin global koordinatash dhe kutat janë absolute. Gjate këtij procesi janë shënuar të gjitha objektet e dukshme si muret rrethuese të shtëpive, pusetat, shtyllat elektrike.

Sheshi i Planit Rregullues kufizohet nga ana Veriore nga rruga kryesore që

kalon në Babrru Qender, nga ana Jugore nga Lumi i Tiranës, ku mendohet se do të kalojë Unaza e madhe e Tiranës. Ndërsa nga ana perëndimore dhe Lindore ky shesh kufizohet me rruget e paraqitura në planimetrinë që është plese e projektit. Në relivimin topografik puna kryesore është përqendruar në pasqyrimin e rrugëve ekzistuese pasi dhe nderhyrja me investim do të përqendrohet kryesisht në trupin e

rrugëve.

Rruget janë paraqitur në planimetrinë e planit rregullues duke identifikuar segmentet dhe unazat me anë të piketave. Konkretisht segmentet janë identifikuar si më poshtë :

- Segmenti 1 nga piketa 1 deri tek piketa 29
- Segmenti 2 nga piketa 30 deri tek piketa 44
- Segmenti 3 nga piketa 45 deri tek piketa 59
- Segmenti 4 nga piketa 60 deri tek piketa 84
- Segmenti 5 nga piketa 85 deri tek piketa 112
- Segmenti 6 nga piketa 113 deri tek piketa 128
- Segmenti 7 nga piketa 129 deri tek piketa 141
- Segmenti 8 nga piketa 142 deri tek piketa 161

TRUPII RRUGES

1. Projektimi i Profilat Terthor te Rruges

Mbeshtetur ne detyren e projektimit por edhe ne rrundesine per te bere zgjerime [ane projektuar dy tipe profilash terthor . Ne planimetrine e planit rregullues jane paraqitur rruget me nje drejtim dhe rruget me dy drejtime. Rruge me nje drejtim jane rruget me gjeresi 3.3 m ku eshte Rruga nr 2-2 $l=140$ ml , Rruga B=5 m ku nuk ka Trotuar 2 kalimshe qe jane 1-1, Rruga 3-3, Rruga 4-4 dhe 5-5 me Gjatesi $L_2= 383$ ml dhe te Gjithe Rruget e tjera B=7.2 m ku jane $b=5+1.1+1.1 =7.2$ m dhe si gjatesi perebejne rreth 1451 m ml. Rruge me dy drejtime+ trotuar me 1 m

Sic shikohet edhe nga profilat terthor tip rruget jane projektuar me trotuar majtas dhe djathtas. Gjereslne e trotuarit e kemi parashikuar me $b=100$ cm por per shkak te situates konkrete ky trotuar nuk del ne cdo rast konsant. Ne askin e rruges, sic; mund te shikohet edhe ne vizatimet e profilave tip jane vendosur tubat e KUZ. Rruga me gjeresi $b=5$ m eshte parashikuar te jete me nje pjerrest terthore dhe kanal in e ujrave te bardha(te shiut) e

ka vetern ne nje drejtim. Rruga me gjeresi $b=7$ m ne drejtimin terthor eshte parashikuar me dy pjerresi dhe respektivisht me dy kuneta dhe kanalet perkatese te ujrave te shiut. Nen njerin trotuar(majtas ose djathtas) jane parashikuar te vendosen tubacionet elektrike, telefonike dhe ato te ndrlcimit. Nen troturain tjeter eshte parashikuar vendosja e tubit kryesor te ujesjellsit. Secili prej profilave terthor tip jane paraqitur edhe ne vizatime.

2.SHTRESAT E RRUGES.

Paketa e shtresave te rruges eshte parashikuar si me poshte i shtresa veshese e asfalto betonit me $t=4$ cm ; shtresa e binderit me trashesi 6 cm ; shtresa e stabilizantit me trashesi 10 cm dhe shtrese cakelli me trashesi 15 cm. Nen shtresen e cakellit eshte parashikuar shtrese niveluese per profilim e cila mund te behet me material cakelli. Materllet e paketes kane percaktimet e veta ne specifikimet teknike.Me ane te profilave gjatesor parashikohen edhe punimet e germimit dhe te nivelimit me profilim me material mbushes prej cakellit.

3.KULLIMI I UJRAVETE SHIUT

Kullimi dhe sistemimi i ujrave siperfaqesore ne te gjithe gjatesine e segmentit rrugor dote behet me kuneta betoni me nga 0.5 gjeresi. Sipas te profilat terthor te rruges me gjeresi $b=3.5$ m ose $b=6$ m kemi nje ose dy kuneta . Poshte kunetes prej betoni ne nfe distance afro 30 metra vendosen puseta monolite Tip gratar (40x40) cm, duke ju pershtatur pjerresive faktlike dhe veprave te shkarkimit ekzistuese te zgjeruara. Ne nje pjese te gjatesise se saj kuneta do te shoqerohet me vendosjen mbi nje shtrese rere 10 cm, te tubave te PVC Ø 315 mm dhe zoomrn per kanalizime te jashtme, ne kuotat e dhena ne profilat terthore. Shkarkimi i ujrave te shiut eshte organizuar duke ndjekur pjerresine e rruges .. Nga ana e projektuesit eshte dhene

zgjdhja e tille qe shkarkimi i ujrave te shiut ne te gjithe gjatesine e rruges se projektuar te jete indare nga kanalizimi i ujrave te zeza.

4.TROTUARI

Parashikohet qe gjeresia mesatare e trotuarit te jete afersisht 1,1 m nga te dy anet e rruges dhe pjerresia terthore e tij eshte 1.5% .Ne zonat ku rruga do te kete degezime trotuari do te nderpritet. Projekti ka parashikuar per ndertimin e tij shtresat: mbushje me zhavorr deri ne 90cm, granile te fraksionuara rocrn dhe pllaka betoni me trashesi 6cm. Trotuari kufizohet me rrugen me bordure te parapregatfur me dimensione (20x35)cm. Projekti ka parashikuar ne anen qe trotuari te kufizohet me avllite e shtepive ndertirnin e mureve me thernele me beton ne varesi te terrenit dhe lartesi mbi trotuar 30cm me qellim ndertimin mbi te te mureve rrethuese te shtepive. Gjate ndertimit te tij duhet lene dhe vendet ku do te mbillen pemet e reja dekorative si dhe ku do te vendoset ndricimi rrugor.

Kanalizime te Ujrave te Zeza

Projektuesi ka parashikuar qe gjate punimeve te rikonstruksionit te sheshit dhe rrugeve te te ndertohet dhe linja e re shkarkimit te ujrave te zeza (KUZ) e cila kalon kudo ne aksin e rruges, duke u vendosur afersisht ne kuoten t.aorn nen kuoten e saj. Projekti ka llogarritur qe linjat e KUZ, te ndertohet duke perdorur tuba SN-8 me diameter ND 315m/m, ND 400m/m, ND 500m/m dhe tuba betoni e beton armeje ND 600m/m e ND 800m/m. Shkarkimi i ujrave te zeza dote behet ne dy pika tek P-30 dhe tek puseta P-420.

Per te gjitha linjat e KUZ jane ndertuar profilet gjatesor . Jane dhene emertirnet e linjave duke identifikuar pusetat me numra te tille si

Linja e Kuz nga P-100 deri tek P-030

Linja e Kuz nga P-135 deri tek P-030

Linja e Kuz nga P-145 deri tek P-135

Linja e Kuz nga P-175 deri tek P-140

Unja e Kuz nga P-156 deri tek P-151

linja e Kuz nga P-151 deri tek P-150

linja e Kuz nga P-200deri tek P-175

linja e Kuz nga P-183 deri tek P-175

Te gjitha keto linja shkarkohen tek puseta P-030.

linjat e tjera te KUZ te tilla si

Linja e KUZ nga P-500 deri tek P-469

Linja e KUZ nga P-469 deri tek P-455

Linja e KUZ nga P-455 deri tek P-435

Unja e Kuz nga P-469 deri tek P-455

Linja e KUZ nga P-435 deri tek P-420

Shkarkojnee tek Puseta P-420.



UJESJELLESË

Nga ana e projektuesit është parashikuar se gjatë punimeve të rikonstruksionit të rrugëve të brendshme të qendres së banuar Babrru Qender të ndertohet edhe linja e re e ujesjellesit në plesën ku do të kryhen punime për rrugët, Linja e ujesjellesit është parashikuar të kalojë vetëm në një krah, në trotuar, duke u vendosur në kuotën t.z.0m nën kuotën e tij. Projekti ka llogaritur që linja e ujesjellesit të ndertohet duke përdorur tuba HDPE-100 PN16. Investitori ka dhënë vetëm një pike lidhëje me rrjetin ekzistues. Është parashikuar ndërtimi i 8 unazave të mbyllura dhe gjatë dimensionimit të tubave është marrë në konsideratë prurjet e nevojshme për çdo kuartall. Për ndërtimin e këtyre unazave janë përdorur tuba HOPE 100 me diametra të tilla si ND160mm, ND110 mm, ND90 mm, ND 75 mm dhe ND 63 mm.

NDRICIMI I RRUGEVE DHE PUNIMET PËR LINJAT E FURNIZIMIT ME ENERGI ELEKTRIKE DHE SINJALIN TELEFONIK

Në trotuar është parashikuar vendosja e pusëve të komandimit të ndricimit elektrik si dhe pusët elektrikë dhe telefonikë. Për këto janë dhënë edhe vizatimet përkatëse të shtritjes së kabllave, skemat e furnizimit me energji dhe linjat telefonike.

Projekti përmban:

1. Planimetritë e rrugës, ujesjellesit dhe kanalizimeve të ujërave të zeza, në të cilën pasqyrohet orientimi i piketazhit të përdorur dhe baza e kuotes relative nga e cila janë bazuar të gjitha matjet topografike të kryera.
2. Planimetrinë në të gjithë gjatësinë prej 1974 m me piketazhë e të detajuar, ku përfshihen në planin rrugor azhurnimet e objekteve civile, social kulturore që shoqërojnë aksin e rrugës, kufizimi i aksit rrugor të asfaltuar, kuletat dhe pusët e shkarkimit të ujërave nga profili i rrugës, trotuaret për kalim këmbesorësh si dhe elementet gjeometrike të rrugës.
3. Profilat gjatësor në aks për rrugën dhe kanalizimet e ujërave të zeza në shkallë vertikale 1:100 dhe horizontale 1:1000, si dhe planimetrinë e ujesjellesit në trotuar ku përcaktohen pjerresitë gjatësore sipas kushteve teknike, kuotat, distancat pjesore e progresive shoqëruar me piketazhin përkatës dhe elemente të tjera

4. Profilat terthore ne shkalle 1:100, ku percaktohen ne menyre te detajuar gjeresia e aksit rrugor ne cdo pike te profilit gjatesor, sipas piketazhit, e cila eshte profektuar me dy gjeresi te ndryshme 8=6 m,dhe 8=3.5 m me pjerresi terthore 2.5%.
5. Profilat terthor tip te rruges si dhe profilat terthor tip te germimit per ujesjellesin e kanalizmet e ujrave te zeza.
6. Jane paraqitur ne menyre te hollesishme detajet e trotuarit, te kunetave, te pusetave te ujesjellesit (1.4x1.4)m e te KUZ-ve (d=800m/m,d=1000m/m,d=1500m/m) dhe te pusetave te shiut (40x40)cm.

Projekti eshte i detajuar per zbatim sipas kushteve teknike te ndertimit te rrugeve duke i u pershtatur ngarkesave automobilistike ne zonat urbane.

Preventivi i zbatimit.



Nga vleresimi i punimeve te ndertim montimit per te gjithë objektin me crnimet e manualeve rezulton qe vlera e plote eshte 137,258,492 Leke me Tvsh .

✚ Ky Studim nuk ka trotuare.

Trotuaret do te ndertohen me gjeresi 2m-ne te dy anet e rruges do te behen me Pllaka.

nje krahe ate verior.

✚ **Sistemi i UJESJELLESIT:** Kjo zone nuk ka rrjet ujesjellesi dhe ka nje projekt pjesore te Zonen Babrru qender , por ka edhe nje Projekt te Plote per gjithë zonen Babrru me te Gjitha Lagjet , Babrru e vjeter, Babrru koder e kuqe , Babrru shpat, Babrru koder e kuqe, Babrru Fushe-Kerçik

Gjelberimi : Kjo zone ka te parashikuar ne projekt ndonje vetem hapje Grope e Bordura Pemesh pemesh por pa Mbjellje ,por ne prespektive ndermarrja qe merret me kete drejtim mund te beje gjelberimin ne kete zone.

✚ Ky Segment nuk ka Ndricim por eshte Parashikuar edhe Ndricimin total te Bilokut

1.4 - Kushtet Klimatike Te Zones

Zona dallohet per dimer te bute me karakteristika te theksuara mesdhetare dhe vetem ne raste te rralla ashpersia e dimrit eshte e ndjeshme .

Si gjithe zona mesdhetare, ne pergjithesi ka nje sasi te konsiderueshme kohe me diell. Kjo arrin ne 2560 ore ne vit, me maksimum ne muajin Korrik me 360 ore dhe minimum 100 ore ne Dhjetor .

Presioni atmosferik sipas te dhenave shume vjeçare leviz nga 752-753 milimetra, e barabarte kjo me 1002.6-100.9 milibar.

Vlerat e temperatures se ajrit ne pergjithesi jane te qendrueshme .

Periudha me temperatura mesatare $> 7^{\circ}\text{C}$ zgjat afersisht 10 muaj.

Kjo zone perfshihet ne zonen klimaterike mesdhetare fushore qendrore. Temperatura mesatare vjetore leviz ne $15-16^{\circ}\text{C}$. Temperatura maksimale eshte regjistruar ne date 13.07.1973 me 43°C , ndersa temperatura minimale eshte regjistruar ne date 15.01.1968 me -14.4°C .

Reshjet, kryesisht në formën e shiut, janë përgjithësisht të dëndura gjatë vitit. Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt . Periudha e ngricave është kryesisht në muajt dhjetor-shkurt . Erërat që fryjnë nuk i kalojnë shpejtësitë 30-50 km/ore . Ujrat nentokesore jane ne kete zone me nivel statik nen thellesine 2 m ne kete aspekt ujrut nentokesore nuk kane ndonje ndikim direkt ne parametrat gjeoteknik te bazes se rrugeve deri ne thellesine 1m. Keto vleresime jane thelbesore per çdo projekt ndertimor dhe hidroteknik

2.1 PERSHKRIMI I RRUGEVE

SHTRESAT RRUGORE

- Duke i qendruar kesaj çeshtje , rruges ekzistuese perbehet nga :
- Zhavorr lumi
- Kalldrem ose cakell gelqerore.
- Asfalt
- Studim i kushteve te shtreses
- Studimi i trafikut.
- Projekti inxhinierik.

2.1- KERKESAT E VEÇANTA TE PROJEKTIT

- Me qëllim që të parashikohet që në fazën e projektimit cilesi e lartë e zbatimit të punimeve rehabilituese, gjatë hartimit të projektit, specifikimeve teknike dhe preventivit të vepres duhet të kihet parasysh kërkesat e veçanta të renditura këtu më poshtë:

HIDROLOGJIA

- Rajoni i Kamzës përfshin troje në zonën fushore me relief subhorizontal
- Tiparet e relievit, kanë tipare hidrogeologjike dhe gjeologjike të veçanta, me shkallë të ulët konsolidimi.
- Ujrat nentoksore janë në këto zone me nivel statik nën thellësinë 2m÷3m; në këto aspekt ujrat nentoksore deri diku kanë ndonjë ndikim direkt në parametrat gjeoteknik të bazës së rrugëve prandaj në pjesën me kuotë me të ulët parashikohet që të këto një shtresë me **mbushje me çakull** ~15cm vende vende tek segmenti i II
- Këto vlerësime janë thelbësore për çdo projekt ndërtimor dhe hidroteknik.

KUSHTET GJEOLGO-INXHINIERIKE DHE HIDROGJEOLGJIKE MBI KUSHTET GJEOLGO -INXHINIERIKE TE ZONES se Babrru Qender

- Në kuadrin të hartimit të projektit për rehabilitimin e infrastrukturës të zonës kryen punime gjeologjike inxhinierike gjatë gjithë gjatësisë rrugës së këtij projekti
- Krahas kësaj u studiuan gjithashtu dhe u morën në konsideratë të dhëna të studimeve të mëparshme për këto zone të cilat na japin një kuadrin të plotë të saj.

NDERTIMI GJEOLGJIK I RAJONIT DHE KUSHTET GJEOLGO-INXHINIERIKE TE ZONES

- Nga ana e ndërtimit gjeologjik, rajoni i Tiranës bën pjesë në strukturën e sinklinalit të Tiranës e cila ndërtohet kryesisht nga formacione e mëshes së Neogenit (N 2) - Këto formacione ndërtohen vargjet kodrinore që qarkojnë qytetin dhe përfaqësojnë nga pak o ranore, alevrolite dhe argjila alevrolitike. Gjithashtu këto formacione shërbejnë si bazament i depozitimit me të reja kuaternare. Depozitimet kuaternare ndërtohen gjithë pjesën fushore ku është ndërtuar qyteti i Kamzës ku bëjnë pjesë zona në studim. Këto depozitime përfaqësohen nga dhera suargjilore, suranore, si dhe depozitime aluvionale zhavorore të lumenjvete Tiranës dhe të Lanës dhe të teracave të tyre, trashësia e

pergjitheshme e te cilave arrin 3-4 m ekstremet e fushes deri ne rreth 20m ne pjeset e tjera te qytetit.

- Era fryn pergjithesisht ne dy drejtime gjate gjysmes se ftohte te vitit mbizoteron juglindja paperjashtuar veriu , ne gjysmen e ngrohte te vitit mbizoteron veriperendimi.

Klauzola qe nuk aplikohen .

- Çfare do Klauzole e specifikimeve qe lidhet me punime apo materiale qe nuk kerkohen ne Preventiv (Tabela e Volumeve) do te konsiderohet e paaplikueshme .

Kushtet sizmike

- Megjithese te gjitha strukturat jane hartuar per kushte sizmike .Kontraktori do te njihet vete me kushtet sizmike te zones nga ku kalon rruga dhe do te marre parasyshe ndikimin ne çmim per ti pershtatur punime me Kodin sizmik te vendit .

Kushtet atmosferike dhe permbytjet .

- Do te merret si e mireqene qe kontraktori gjate pergatitjes se ofertes se tij do te kete marre parasyshe te gjitha kushtet e mundeshme atmosferike dhe rastet e permbytjeve ne kohen e perfundimit si dhe gjate punimeve permanente dhe te perkohshme . Kontraktorit nuk i takon asnje pagese shtese si pasoje e ndodhjes .

Ne zgjidhjen e projektit jane pasur parasyshe:

- a) Zgjidhja ne anen Planimetrike te rruges.
- b) Zgjidhja ne anen altimetrike te rruges.
- c) Elementet sociale te rruges.

1. Zgjidhja Planimetrike

Ne zgjidhjen planimetrike eshte pasur parasyshe asfaltimi i rruges te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese dhe te lihen hapesirat e nevojshme per zhvillimin ne te ardhmen te infrastruktures nentokesore.

Ne kryqezime eshte bere rakordimi i kthesave me rreze te tille qe lejon kthimin normal te mjeteve.

2. Zgjidhja Altimetrike.

Nga ana altimetrike relievi faktik ne drejtimin gjatesor ka nje pjerresi te relativisht te madhe nga jugu ne veri dhe nga lindja ne perendim. Meqe objekti i ri do te

ndertohtet mbi nje rruge ekzistuese e cila ka nivelete te çrregullt, do te synohet ne krijimin e nje nivelete me pjerresi te lehte e uniforme.

3. Profili Gjatesor.

Profili gjatesor perfaqeson prerjen e rruges sipas aksit te saj ne drejtimin vertikal. Profili gjatesor eshte hartuar ne shkalle vertikale 1:100 dhe ne shkalle horizontale 1:1000.

Ne te jane paraqitur:

- Vija e Terrenit
- Vija e Projektit
- Disnivelet e Vijes se Projektit
- Numri i Piketes (Seksionit)
- Kuota e Terrenit
- Kuota e Projektit
- Distanca Pjesore
- Distanca Progressive

4. Profilat Terthore.

Profilat terthore perfaqesojne prerje te rruges terthor me aksin e saj ne drejtimin vertikal.

Profilat terthore jane hartuar ne shkalle vertikale dhe horizontale 1:100.

Ne profilat terthore jane paraqitur:

- Numri i profilit
- Distanca progressive
- Vija e terrenit
- Vija e projektit
- Disnivelet e vijes se projektit
- Numri i piketes
- Kuotat e terrenit
- Kuotat e projektit
- Distanca pjesore nga aksi
- Distanca pergjithshme nga aksi

5. Profilat Terthore.

Ne profilat tip jane paraqitur ne menyre te detajuar ne shkalle 1:50

- Shtresat rrugore
- Dimensionet e tyre
- Vendosja e tyre
- Distancat
- Zona ku aplikohet profili tip

6. Zgjidhja sociale.

Duke pasur parasysh qe kjo zone eshte ne zhvillim e siper eshte pasur parasysh qe kjo rruge te behet me parametra qe t'i pershtaten zhvillimit te zones dhe hyrje daljet nga shtepite te kene lirshmeri.

7. Llogaritja e shtresave te rruges.

Nga studimi i gjendjes ekzistuese del qe asfaltimi do te behet ne te dy anet e aksit te rruges ekzistuese me pjerresi ne njerin krah.

8. Shtresat e rruges sipas projektit

Per te gjithë segmentin rrugor shtresat e dala nga llogaritja do te jene:

- Cakull t=20 cm
- Binder 6 cm
- Asfaltobeton 4cm
- Stabilizant 10cm

4. PERMBAJTJA E PROJEKT - ZBATIMIT

PROJEKT - ZBATIMI PERMBAN KETO KAPITUJ

1. KAPAKU I PROJEKTIT
2. FOTO TE OBJEKTIT
3. PLANIMETRIA EKZISTUESE
4. PLANIMETRIA E PRISHJEVE
5. PLANIMETRIA E ASFALTIT
6. PROFILAT TERTHORE TIP
7. PROFILAT TERTHORE
8. PROFILI GJATESOR I RRUGES